Neni 1
Qëllimi

Kjo rregullore përcakton karakteristikat e bursave për studentët e Shkollës së Lartë "Hëna e Plotë" (Bedër). Studentët që plotësojnë kriteret e përcaktuara në këtë rregullore kanë të drejtë të përfitojnë nga bursat e Shkollës së Lartë "Hëna e Plotë"(Bedër).

Neni 2
Baza ligjore

Kjo rregullore bazohet në ligjin për arsimin e lartë dhe Statutin e Shkollës së Lartë "Hëna e Plotë" (Bedër).

Neni 3
Komisioni i administrimit të bursave

Komisioni i administrimit të bursave është organi përgjegjës për administrimin e procesit të dhënies së bursave dhe përbëhet nga dekani i studentëve, përgjegjësi i zyrës së pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve dhe një përfaqësues nga stafi akademik i cili zgjidhet nga Këshilli i Administrimit të Shkollës së Lartë "Hëna e Plotë" (Bedër).

Neni 4
Procedura e aplikimit për bursë

Studentët e interesuar duhet të plotësojnë formularin e bursës pranë zyrës së përzgjedhjes dhe pranimit të studentëve. Zyra e përzgjedhjes dhe pranimit të studentëve ia përcjell formularët në fjalë komisionit të administrimit të bursave. Komisioni i administrimit të bursave analizon dhe vlerëson formularët e aplikimit brenda shtatë ditëve nga dita e plotësimit të formularëve nga ana e studentëve. Për çdo vit akademik vijues, bursat rishqyrtohen nga komisioni i administrimit të bursave. Në rastin e përfitimit të bursës nga ndonjë institucion tjetër, studenti nuk mund të përfitojë bursë nga institucioni ynë.

Neni 5
Përmbajtja e bursës

a. Këto bursa janë të vlefshme vetëm për studentët që plotësojnë kriteret e pranimit.
b. Këto bursat janë vetëm bursa studimi dhe nuk përfshijnë akomodimin dhe ushqimin. Nga ky rregull përjashtohen kategoria e studentëve të parashikuar në pikën 3 të nenit 6.
c. Bursat e cituara janë të vlefshme vetëm për 6 semestra. Nga ky rregull përjashtohen kategoria e studentëve të parashikuar në pikën 3 të nenit 6.
d. Studentët që plotësojnë kriteret për të përfituar më shumë se një bursë nuk përfitojnë të gjitha bursat, por do të përfitojnë vetëm bursën më të lartë.
e. Studentët që përfitojnë bursë punojnë 120 orë punë të ndryshme që përcaktohen nga organet drejtuese të Shkollës së Lartë "Hëna e Plotë"(Bedër) (si reklama dhe punë të tjera që mund t'u ngarkojnë njësitë administrative etj.).
f. Zbritja e tarifës së studimit do të konsiderohet bursë për studentët që fitojnë të drejtën e bursës.

Neni 6
Bursë nga shoqëria

1. Studentët të cilët kanë kryer studimet në të gjitha medresetë që varen nga Komuniteti Mysliman i Shqipërisë, pasi fitojnë të drejtën për t'u regjistruar në Shkollën e Lartë "Hëna e Plotë" (Bedër), përfitojnë 20% ulje në koston e arsimimit, në formën e bursës.
2. Studentët të cilët kanë kryer studimet në medresetë që varen nga Komuniteti Mysliman i Shqipërisë, por administrohen nga fondacioni "Sema", pasi fitojnë të drejtën për t'u regjistruar në Shkollën e Lartë "Hëna e Plotë" Bedër, përfitojnë 35% ulje në koston e arsimimit, në formën e bursës.
3. Studentët të cilët kanë kryer studimet në medresetë që varen nga Komuniteti Mysliman i Shqipërisë, por administrohen nga fondacioni "Sema", nëse fitojnë të drejtën për t'u regjistruar në Departamanetin e Shkencave Islame pranë Shkollës së Lartë "Hëna e Plotë" Bedër, do të përfitojnë zbritje të tarifës së studimit në formë burse 100% dhe akomodimin për 5 vite akademike. Nuk përfshihen në këtë bursë librat dhe shpenzime të tjera arsimore.

Neni 7
Bursa e suksesit

Studentët të cilët kanë përfunduar shkollën e mesme në një nga shkollat me të cilat Shkolla e Lartë "Hëna e Plotë" (Bedër) ka marrëveshje dhe janë renditur në vend të parë, të dytë dhe të tretë dhe në qoftë se e vërtetojnë me dokumentacionin përkatës, me propozim të rektorit dhe me miratim të Këshillit të Lartë, mund të zgjedhin cilin degë të duan, pa u futur në provimet e pranimit dhe do të përfitojnë zbritje të tarifës së studimit në formë burse, si më poshtë:

1. Nxënësit të parë 100%
2. Nxënësit të dytë 75%
3. Nxënësit të tretë 50%

Studentët të cilët kanë përfunduar shkollën e mesme në një nga shkollat me të cilat Shkolla e Lartë "Hëna e Plotë" (Bedër) nuk ka marrëveshje dhe janë renditur në vend të parë dhe në rast se e vërtetojnë me dokumentacionin përkatës, me propozim të Rektorit dhe me miratim të Këshillit të Lartë, do të përfitojnë zbritje të tarifës së studimit në formë burse si më poshtë:

1. Nxënësit të parë 50%

Neni 8
Bursa e suksesit të lartë

a) Studentët të cilët në radhitjen e suksesit të provimeve ndërkombëtare dhe kombëtare janë renditur në vend të parë, të dytë dhe të tretë dhe në rast se e vërtetojnë këtë fakt me dokumentacionin përkatës, me propozim të rektorit dhe me miratim të

Këshillit të Lartë, do të përfitojnë zbritje të tarifës së studimit në formë burse, si më poshtë:

1. Nxënësit të parë 100%
2. Nxënësit të dytë 75%
3. Nxënësit të tretë 50%

b) Studentët të cilët marrin pjesë në radhitjen e mëposhtme në provimin e përgjithshëm shtetëror dhe e vërtetojnë këtë fakt përmes një dokumenti, me propozim të rektorit dhe me miratim të Këshillit të Lartë, do të përfitojnë zbritje të tarifës së studimit në formë burse si më poshtë:

1. Studentët që marrin pjesë në radhitjen nga 1 – 500 përfitojnë zbritje të tarifës së studimit në formë burse 100%;
2. Studentët që marrin pjesë në radhitjen nga 501 - 1000 përfitojnë zbritje të tarifës së studimit në formë burse 75%;
3. Studentët që marrin pjesë në radhitjen nga 1001 - 2000 përfitojnë zbritje të tarifës së studimit në formë burse 50%.

c) Studentët të cilët tregojnë sukses në provimin e Toeflit dhe e vërtetojnë këtë fakt përmes një dokumenti, me propozim të rektorit dhe me miratim të Këshillit të Lartë, përfitojnë zbritje të tarifës së studimit në formë burse, si më poshtë:

1. Studentët që marrin 100 - 120 pikë përfitojnë zbritje të tarifës së studimit në formë burse 100%;
2. Studentët që marrin 90 - 100 pikë përfitojnë zbritje të tarifës së studimit në formë burse 75%;
3. Studentët që marrin 80 - 90 pikë përfitojnë zbritje të tarifës së studimit në formë burse 50%.

d) Studentët të cilët tregojnë sukses në provimin e SAT-it dhe e vërtetojnë këtë fakt përmes një dokumenti, me propozim të rektorit dhe me miratim të Këshillit të Lartë, përfitojnë zbritje të tarifës së studimit në formë burse, si më poshtë:

1. Studentët që marrin 1900 - 2000 pikë përfitojnë zbritje të tarifës së studimit në formë burse 100%;
2. Studentët që marrin 1800 - 1900 pikë përfitojnë zbritje të tarifës së studimit në formë burse 75%;
3. Studentët që marrin 1700 - 1800 pikë përfitojnë zbritje të tarifës së studimit në formë burse 50%.

e) Studentët që janë të suksesshëm në festivalin ndërkombëtar të gjuhës Turke të organizuar në Shqipëri apo Turqi dhe e vërtetojnë këtë fakt përmes një dokumenti, me propozim të rektorit dhe me miratim të Këshillit të Lartë, përfitojnë zbritje të tarifës së studimit në formë burse, si më poshtë. (Kjo bursë është e vlefshme për të gjitha programet e studimit)

1. Studentit të parë 100%
2. Studentit të dytë 75%
3. Studentit të tretë 50%

Neni 9
Bursa e suksesit në fushën e kulturës, artit dhe sportit

Studentët të cilët zotërojnë një përgatitje të lartë profesionale në fushën e kulturës, artit dhe sportit dhe e vërtetojnë këtë fakt përmes dokumentacionit përkatës, me propozim të rektorit dhe me miratim të Këshillit të Lartë, mund tu jepet bursë në formën e zbritjes së tarıfës së studimit.

Neni 10
Shkaqet e ndërprerjes së bursës

a) Studenti i cili largohet nga Shkolla e Lartë "Hëna e Plotë"(Bedër) për arsye të ndryshme, humbet të drejtën për të përfituar bursë që nga data e largimit.
b) Në rast se studenti transferohet në një program tjetër studimi brenda Shkollës së Lartë "Hëna e Plotë" (Bedër), atëherë ai humbet të drejtën e bursës.
c) Studentët që kanë përfituar bursë janë të detyruar të marrin pjesë të paktën 70% të orëve të procesit mësimor gjatë semestrit.
d) Çdo semestër mesatarja e përgjithshme e studentëve që kanë përfituar bursë nuk duhet të jetë nën 2.5.
e) Studentët që kanë përfituar bursë nuk duhet të ngrijnë studimet dhe nuk duhet të marrin marrë asnjë masë disiplinore.

Neni 11
Hyrja në Fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi ditën e miratimit në Këshillin e Lartë.

Neni 12
Zbatimi

Zbatimi i kësaj rregulloreje sigurohet nga rektori i Shkollës së Lartë "Hëna e Plotë" (Bedër).